



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.1/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit M.K, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruesve të ankesës Xh.K dhe I.N., që të dy avokat në Prishtinë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 01.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e ankuesve Xh.K dhe I.N., që të dy avokat në Prishtinë, e parashtruar ndaj gjyqtarit M.K, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 31.01.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga Xh.K dhe I.N., që të dy avokat në Prishtinë, ndaj gjyqtarit M.K, me arsyetimin se që të dy sipas autorizimit e përfaqësojnë paditësin/propozuesin B.Sh, nga Peja në çështjen juridiko civile kundër të paditurit/kundërshtarit të propozimit M.Sh, nga Peja, me bazë juridike kthim i mjeteve monetare si pasojë e pasurimit të pabazë, me propozim për caktim të masës së sigurisë, të cilin propozim e ka refuzuar Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm me Aktvendimin C.nr.1392/20, të datës 07.09.2022, aktvendim ky i prishur nga Gjykata e Apelit pas aprovimit të ankesës së të autorizuarve të paditësit/propozuesit. Pas kthimit të çështjes në rivendosje, gjykata ka caktuar seanca gjyqësore me datë 17.11.2022, e cila është shtyrë për datë 29.11.2022, seancë kjo e mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, në të cilën gjykata e ka shpallur si të përfunduar shqyrtimin për propozimin e caktimit të masës së sigurisë dhe që nga shpallja e përfunduar e shqyrtimit të propozimit për caktimin e masës së sigurisë, ende nuk kanë pranuar vendim lidhur me këtë çështje andaj, konsiderojnë se gjykata është treguar mospërfillëse në respektimin e afateve dhe ka tejkaluar çdo afat ligjor i përcaktuar sipas dispozitave të nenit 170 par.1 lidhur me nenin 172 par.1 të LPK-së e gjithashtu lidhur me nenin 175 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se “Dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 par.2 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kemi të bëjmë me aktvendimet”, bazuar në këto vlerësojnë se për dhënien, hartimin me shkrim dhe dërgimin e aktvendimit për masë të sigurisë vlen afati i njëjtë si për aktgjykime, e i cili afat konform nenit 153 par.1 të LPK-së, është afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Për më tepër, kanë shtuar se e gjithë rrjedha e procedurës së çështjes është bërë me shkelje të konstatimit të gabuar të fakteve, shkeljes së afateve ligjore krejtësisht në mënyrë të njëanshme dhe përveç kësaj, lidhur me propozimin për caktim të masës së sigurisë, gjyqtari i çështjes e ka obliguar palën që të paguaj garancionin mirëpo, çuditërisht si asnjëherë më parë në praktikën gjyqësore, gjyqtari i çështjes e ka refuzuar propozimin për caktim të masës së sigurisë dhe që nga ajo kohë mjetet e deponuara kanë mbete në llogarinë e KGJK-së. Si rezultat i gjithë këtyre stër-vonesave dhe veprimeve të gjykatës tek pala janë krijuar dyshime se gjyqtari i çështjes mund të jetë i ndikuar dhe i njëanshëm andaj, kanë kërkuar që të veprohet brenda kompetencave ligjore kundrejt gjyqtarit të çështjes.

Me datë 03.02.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga XH.SH dhe I.N., të dy avokat në Prishtinë, ndaj gjyqtarit M.K.

Gjyqtari M.K në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesve të ankesës ka deklaruar se lëndën civile të paditësit B.Sh, nga Peja kundër të paditurit M.Sh, nga Peja, me bazë juridike pasurim i pabazë, me propozim për caktim të masës së sigurisë, e ka pranuar në punë nga gjyqtari paraparak i cili është avancuar në Gjykatën e Apelit dhe pas prishjes së aktvendimit dhe kthimit të kësaj lënde në rivendosje nga Gjykata e Apelit, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe se pretendimi i parashtruesve të ankesës se është tejkaluar afati për përpilim të aktvendimit, nuk qëndron pasi ankesa disiplinore është parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me datë 25.01.2023 dhe është protokolluar me datë 30.01.2023 ndërsa, Aktvendimi lidhur me propozimin për caktim të masës së sigurisë është marrë me datë 13.01.2023 dhe se paditësit – propozuesit e masës së sigurimit, të njëjtin e kanë pranuar në mënyrë të rregullt me datë 18.01.2023, rrethanë që kjo vërtetohet me fletëkthesën që gjendet në shkresat e lëndës, përveç kësaj, të njëjtit kanë parashtruar ankesë ndaj këtij aktvendimi, me datë 19.01.2023. Pra, pretendimet e parashtruesve të ankesës se nuk është vendosur dhe nuk është përpiluar vendimi me shkrim, nuk qëndrojnë, për më tepër të njëjtit, deri në momentin e pranimit të vendimit për refuzim të masës së sigurisë, nuk kanë paraqitë asnjë shqetësim. Tutje, sa i përket kohës së përpilimit të vendimit, gjyqtari ka sqaruar se gjatë muajit dhjetor 2022, ka qenë i angazhuar me trajnime dhe aktivitete në KGJK, ka pas edhe lëndë të tjera në punë si dhe kanë qenë disa ditë pushimi për festat e fund vitit dhe se në rastin konkret, nuk është shkelë asnjë afat për përpilim të aktvendimit sepse me asnjë dispozitë të LPK-së, nuk është përcaktuar periudha kohore për përpilim të vendimeve jashtë seancës. Pretendimet për njëanshmëri, poashtu, nuk qëndrojnë dhe se asnjëra nga palët nuk ka deklaruar asnjë vërejtje ndaj tij si gjyqtarë gjatë seancave njëloj si nuk qëndrojnë as pretendimet për zvarritje të procedurës pasi, seanca është caktuar menjëherë pas kthimit të lëndës në rivendosje, rrethanë kjo që mund të vërtetohet me shikimin e shkresave të lëndës ndërsa, sa i përket pretendimeve lidhur me caktimin e garancionit dhe lidhur me provat që janë dorëzuar për ta bërë të besueshme kërkesën për masën e sigurimit, gjyqtari ka theksuar se të njëjtat i ka arsyetuar në Aktvendimin C.nr.1392/20, të datës 1.01.2023 dhe këto janë pretendime që mund të atakohen me mjet të rregullt juridik – ankesë në Gjykatën e shkallës së dytë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit M.K, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Fillimisht, kërkesa e parashtruesve të ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit M.K, për shkak se gjyqtari nuk ka respektuar afatin për përpilim të aktvendimit, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve meqë, ky ligj në nenin 5 pika 2.7 të saj, si shkelje të natyrës disiplinore ka paraparë rrethanën kur gjyqtari me dashje apo nga pakujdesia *“në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj”*, ndërsa, në rastin konkret rezulton se gjyqtari është vonuar disa ditë në nxjerrjen e një aktvendimi dhe atë për shkak se i njëjti gjatë muajit dhjetor, ka qenë i angazhuar në trajnime si dhe ka qenë anëtar i një komisioni në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, shto këtu faktin se muaji dhjetor ka pas edhe disa ditë pushimi për festat e fund vitit.

Ndërsa, pretendimi i parashtruesve të ankesës se gjyqtari është treguar i njëanshëm dhe se i njëjti mund të jetë i ndikuar, nuk janë arsyetuar në asnjë mënyrë andaj, në rrethana të tilla, e në mungesë të provave, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, e pati të pamundur të vërtetojë pretendimet e tilla.

Lidhur me pretendimet e parashtruesve të ankesës disiplinore se gjyqtari M.K, e ka obliguar propozuesin e masës së sigurimit për pagesën e garancionit dhe përkundër praktikës gjyqësore e ka refuzuar propozimin për caktim të masës si dhe e gjithë rrjedha e procedurës së çështjes është bërë me shkelje të konstatimit të gabuar të fakteve, Kryetari i Gjykatës si Autoritet Kompetent gjen se, pretendimet e tilla janë pretendime ankimore për të cilat vendosë gjykata e shkallës së dytë, si gjykatë kompetente për të vlerësuar saktësinë dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe se të njëjtat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore e as nuk janë bazë për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.1/23, me datë 01.03.2023

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit M.K*
- 3. Parashtruesve të ankesës – Xh.K.
dhe I.N. – të dy avokat në Prishtinë*